



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2890/ Prot.
12

Tiranë, më 16.10.2024

VENDIM

Nr. 68 datë 16.10 2024

“PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E SENATIT AKADEMIK TË UST NR. 119, DATË
14.10.2021”

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Senati Akademik i Universitetit të Sporteve të Tiranës, me propozim të Rektoratit të UST, në mbledhjen e dates 16.10.2024

VENDOSI:

1. Në pikën 3 të Vendimit nr. 119, datë 14.10.2021 të Senatit Akademik të Universitetit të Sporteve të Tiranës, bëhen ndryshimet dhe shtesat me përmbajtjen si vijon:

Ishte:

“3. Studentët që rregjistrohen në ciklin e dytë të studimeve “Master i Shkencave” për vitin 2021-akademik 2022, duhet të kenë fituar një diplomë në një nga gjuhët e përcaktuara, brenda vitit të parë të studimeve master dhe ta dorëzojnë atë në Sektorin e Sekretarisë Mësimore Digjitale, shoqëruar me një deklaratë të firmosur nga student për plotësimin e këtij kriteri para sezonit të provimeve (formulari i deklaratës bashkëngjitur).

Bëhet:

“3. Studentët që do të pranohen në programin/et e studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” dhe “Master Profesional”, duhet të paraqesin çertifikatën e gjuhës së huaj të fituar sipas kërkesave të përcaktuara në Udhëzimin e MAS Nr.52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar.”

3.1 Afati për dorëzimin e certifikatës së gjuhës së huaj, fillon menjëherë me fillimin e vitit akademik dhe përfundon një ditë para dorëzimit të temës së diplomës.

3.2 Në rast të mosrespektimit të kërkesave dhe afatit të përcaktuar në pikat 3 dhe 3.1 të këtij vendimi, studenti/ët nuk fitojnë diplomën që lëshohet në përfundim të programit të studimeve.

2. Për njohjen dhe zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen: Njësitë Kryesore të UST; Zv. Rektori për anën mësimore; Njësitë bazë përgjegjëse për Programin/et e studimeve; Koordinatorët e Programeve të Studimit dhe studentët.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Sporteve të Tiranës.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Agron KASA

